

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve: *Më poshtë janë specifikimet e materialit të butë që do të lahet, blihet dhe zëvendësohet sipas jetëgjatësisë së materiali përkatës dhe kushteve të autoritetit kontraktor.*

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATERIALIT TË BUTË PËR PACIENTIN				
Emërtimi	Njësia	Specifikimet Teknike	Dimensionet	Lloji i materialit
Dyshek tek spitalor	Copë	Dysheku të jetë i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbërja nga brënda me dy shtresa vatine të fortë, ku nga njëra anë të ketë porozitet për qarkullimin e ajrit, dhe i veshur nga jashtë me mbulesë të fortë të padepërtueshme, injifugo (kundër zjarrit), antibakteriale dhe antialergjike. Të ketë të shënuar datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	190x90x10 cm	
Çarçafe shtrati i poshtem	Copë	270 – 290 gr/m2, Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë e bardhë. Logoja e Spitalit të SUT-së me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	280x160 cm	100 % pambuk
Çarçafe shtrati i Siper	Copë	270 – 290 gr/m2, Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë e bardhë. Logoja e Spitalit të SUT-së me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	280x160 cm	100 % pambuk
Këllëf dysheku (mbulesë e gomuar)	Copë	Material nga njera ane pambuk dhe nga ana tjetër e gomuar impermeable (e papershkueshem nga uji) me permasa 200 x90 cm qepje me llastik per te futur dyshekun , te datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Logo SPITALI..... me emërtesën sipas kërkesës së autoritetit kontraktor,	190x80	100 % pambuk + material I gomuar
Jastëk	Copë	Mbushje uniforme me fibra sintetike, ngjyrë e bardhë, datën e futjes në materialit të butë në përdorim në	40x80 cm	Fibra Sintetike

		shërbimin mjekësor.		
Këllëf Jastëku	Copë	Mbulesë dyshe, ku nga njëra anë ka një të çarë si xhep, për të lejuar futjen e jastëkut. Ngjyrë e bardhë. 160 – 180 gr/m2. Logo SPITALI..... me emërtesën sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	50x80 cm	100 % pambuk
Jorgan me vatine	Copë	Me mbushje me vatine , me tegela ndarese ne forme kuadrati , veshja e jashteme material pambuku, ngjyre e bardhe	140X180	
Carcaf Zarf		Ngjyrë e bardhë. Logoja e Spitalit të SUT-së me emërtesën me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	220 x 160 cm	100 % pambuk
Pizhama Pacienti	Copë	Pizhama komplet (bluze +pantallona) , material i trikotuar i plote njëngjyreshe ,pesha 350 gr/m2 , pantallonat me llastik , xhaketa me jake kemishe ose jake V, me mëngë të gjata të gjëra, masat (XS, S,M, L, XL, XXL) me kopsa perpara dhe dy xhepa. Specifikat e me sipërme - sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Me logon e Spitalit të SUT-së, si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	Gjatësia sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	Materiali i trikotuar
Peceta kirurgjie 100 x 100 (telina)	Cope	Te jete material fanellat ngjyre jeshile	100 x 100 cm	100% pambuk,
Pandofla Personeli dhe Pacienti	Copë	Pandofla për përdorim spitalor, material plastic, me gome poroze me ngjyra te ndryshme, e mbyllur nga përpara dhe me vrime për ajrosje, e paisur me një shtresë ortopedike për të lehtësuar qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë. Materiali të jetë antirreshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji. Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	Numrat e pandoflave sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	Materiali të jetë plastic, antirreshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATERIALIT TË BUTË TË EKIPIT TË SALLAVE OPERATORE DHE TË SALLAVE OPERATORE

Emërtimi	Njësia	Specifikimet Teknike	Dimensionet	Lloji i materialit
Kostume ekipi salle jo sterile Bluzë dhe Pantallona	Copë	Bluzë dhe Pantallona: Bluzë me jakë në formë V me mëngë të shkurtra të gjëra, me xhep lart majtas ku në palën e xhepit të shënohet pozicioni I personelit dhe logo e SUT..... Nga brenda bluzës të shënohet iniciali i emrit	gjatësia e bluzës 71 cm; gjatësia pantallonit sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	Përbërje 100% pambuk,

		dhe mbiemri i plotë i personelit si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Pantallona unisex , me llastikë në pjesën e belit, me ose pa xhepa në pjesën e përparme. Masat (S, M, L, XL) sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Densiteti i thurjes 160- 180 gr. Ngjyrë jeshile e errët		
Kapuçe personeli salle jo sterile	Copë	Capuc mjeku dhe infermieri , masa te ndryshme , perberja pambuk , ngjyre jeshile me logo te SUT	Nr. te ndryshme	Përbërje 100% pambuk,
Kompresa Operacioni	Copë	Material pambuku me ngjyre jeshile, si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	100cm x100 cm	pambuk 100%, ngjyre jeshile
Carcafe operacioni permasa 110*130	Copë	Material pambuku me ngjyrë jeshile, si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	110 cm x 130 cm	pambuk 100%
Carcafe operacioni permasa 140*130	Copë	Material pambuku me ngjyrë të jeshile, si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	140 cm x 130 cm	pambuk 100%
Perparese operacioni	Copë	Perparese jo sterile , mberthehen nga mbrapa ,ngjyre jeshile prerje M,L,XL. Menget ne fund me trikotazh		pambuk 100%

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATERIALIT TË BUTË PËR PERSONELIN MJEKSOR

Emërtimi	Njësia	Specifikimet Teknike	Dimensionet	Lloji I materialit
Përparëse Mjeku (Mashkull dhe Femër) unisex	copë	Material Pambuku, ngjyrë e bardhë, ku në të majtë ka një xhep të vogël të drejtë ku do të vendoset logoja e Spitalit të SUT-së. Nga brenda të shënohet iniciali i emrit dhe mbiemri i plotë i personelit, si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Densitetin e thurjes 230 gr/m². Jaka e përparësës të jetë e prerë drejtë (jakë ruse), gjatësia sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, me mëngë të gjata, pjesa e mbrapme me një të çarë për të lejuar lëvizjen, dhe përpara të jetë me perçina, si dhe me dy xhepa anash të futur.	Gjatësia e përparësës dhe masat (S,M,L,XL,XXL), sipas kërkesës së autoritetit.	100% pambuk,
Kostume Infermieri / mjeku	copë	Bluza me jakë V të trashë me xhep të vogël lart majtas, ku të shënohet pozicioni dhe logoja e Spitalit të SUT-së. Nga brenda bluzës të shënohet iniciali i emrit dhe mbiemri i plotë i personelit, si dhe datën e futjes në	Masat (S,M,L,XL,XXL) sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Gjatësia e bluzës 71 cm.	Materiali 65% pambuk dhe 35 % poliestër, lahet në temperaturë 60°.

(Bluzë me Pantallona) unisex		materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Me mëngë të shkurtra të gjëra dhe me dy xhepa anësorë poshtë bluzës. Pantallona unisex , me llastikë në pjesën e belit, me ose pa xhepa në pjesën e përparme sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Ngjyrat sipas kërkesës së AK Densiteti i thurjes 160- 180 gr /m ²	Gjatësia pantallonit sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	
Peshqire personeli / pacienti	cope	Material pambuku, ngjyre e bardhe me logon e SUT-se si si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	100x50	100% pambuk,

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike të Menaxhimit të Proçesit të Lavanderisë

Operatori ekonomik do të ofrojë shërbimin e tij, nga proçesi i lavanderisë deri tek kompletimi me inventarin e materialit të butë të shtratit të pacientit.

Sipërmarrësi është i detyruar të disponojë të gjitha kapacitetet larëse dhe dezinfektuese, tharëse, hekurosëse dhe paketuese. Përveç kësaj, sipërmarrësi duhet të sigurojë për zëvendësimin e materialit të butë, nëse është i dëmtuar apo i amortizuar (sipas kohës së tyre të amortizimit dhe sipas nevojës).

Sipërmarrësi siguron inventarin e materialit të butë të nevojshëm, për një kompletim të rregullt sipas normave të shtratit që ka Spitali i Traumes, me emërtimin/sigllën përkatëse të institucionit kontraktues, datën e futjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Inventari i materialit të butë, në kuptimin e kësaj kontrate, emërtimi, përmasat, dimensionet, cilësia dhe normat e përdorimit në kohë, do të përfshihen në specifikimet përkatëse.

Sipërmarrësi do të lajë, dezinfektojë, thajë, paketojë, të transportojë dhe shpërndajë deri në pavion bazën e materialit të butë, si dhe të bëjë shërbimin e plotë deri tek shtrati i pacientit.

Rregullat e shtrimit të shtratit do të bëhen, sipas protokolleve të kujdesit infermieror, manualit të kujdesit spitalor, rregullave të higjienës me njoftimin e hapjes së kartelës së re të shtrimit nga K/inferm e shërbimit, si dhe sa herë të nevojitet nga shërbimi.

Larja dhe dezinfektimi, në repartin e lavanderisë do të bëhet në mënyrë të përqëndruar, duke respektuar të gjitha procedurat dhe protokollet e higjienës, nga marrja në dorëzim e materialit të butë të papastër të ndarë sipas nëndarjeve dhe zonave të rrezikshmërisë (thasët me ngjyrë), tek dorëzimi i materialit të butë, të larë, të hekurosur dhe të pakeluar sipas këtyre protokolleve, deri në shtrimin e shtratit të pacientit sipas protokolleve infermiore. Pjesë e këtij proçesi është edhe sigurimi i pastrimit të plotë kimik – mekanik, në temperaturat e duhura, dhe i proçesit të hekurosjes.

Larja e inventarit të materialit të butë, do të bëhet sipas frekuencave të percaktuara në tabelen e mëposhteme dhe sipas nevojës.

N r.	INVE NTA RI	Kellef dysheku e gomuar	Jasteke	Kellefe Jastek u	Carcafe Shtrati (poshte)	Carcaf e Shtrati (siper)	Kompre sa mjekimi (telina)	Jorgan me Vatine (per periudhen qe perdoret)	Carcafi zarf (per periudhe n qe perdoret)	Peshqire	Pizhama	Pandofla pacienti
		Frek/ ditore	Frek/ ditore	Frek/ ditore	Frek/ ditore	Frek/ ditore	Frek/ ditore	Frek/ ditore	Frek/ ditore	Frek/ ditore	Frek/ ditore	Frek/ ditore
1	Kirurgjia e l-re	12- here ne vit	2- here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	51 here ne vit	1 here ne dite	1 here ne vit	51 here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	2- here ne vit
2	Kirurgjia e ll-te	12- here ne vit	2- here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	51 here ne vit	1 here ne dite	1 here ne vit	51 here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	2- here ne vit
3	Ortopedia	12- here ne vit	2- here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	51 here ne vit	1 here ne dite	1 here ne vit	51 here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	2- here ne vit
4	Kirurgji Rikonstruktive	12- here ne vit	2- here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	51 here ne vit	1 here ne dite	1 here ne vit	51 here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	2- here ne vit
5	Pranim Urgjenca	24- here ne vit	2- here ne vit	102 here ne vit	1 here ne dite	182 here ne vit (1 here ne 2 dite	0	2- here ne vit	182 here ne vit (1 here ne 2 dite	102 here ne vit	0	0
6	Semundje te Brendshme 1	12- here ne vit	2- here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	51 here ne vit	0	1 here ne vit	51 here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	2- here ne vit
7	Semundje te Brendshme 2	12- here ne vit	2- here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	51 here ne vit	0	1 here ne vit	51 here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	2- here ne vit
8	Neurokirurgji	24- here ne vit	12- here ne vit	1 here ne dite	1 here ne dite	182 here ne vit (1 here ne 2 dite	1 here ne dite	2- here ne vit	182 here ne vit (1 here ne 2 dite	102 here ne vit	102 here ne vit	2- here ne vit
9	Reanimacioni	24- here ne vit	24- here ne vit	1 here ne dite	1 here ne dite	182 here ne vit (1 here ne 2 dite	1 here ne dite	2- here ne vit	182 here ne vit (1 here ne 2 dite	102 here ne vit	0	0

1 0	ORL- Maksilofacial	12-here ne vit	2- here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	51 here ne vit	1 here ne dite	1 here ne vit	51 here ne vit	102 here ne vit	102 here ne vit	2- here ne vit
1 1	Konsulta	12-here ne vit	2- here ne vit	0	51 here ne vit	0	1 here ne dite	1 here ne vit	0	102 here ne vit	0	0
1 2	Fizioterapia	12-here ne vit	2- here ne vit	51 here ne vit	51 here ne vit	0	1 here ne dite	1 here ne vit	0	51 here ne vit	0	0
1 3	Imazheria	12-here ne vit	2- here ne vit	0	51 here ne vit	0	0	1 here ne vit	0	51 here ne vit	0	0

SALLAT E OPERACIONIT	Frekuence
Carcaf operacioni permasa 1 (110*130)	1 here ne dite
Carcaf operacioni permasa 2 (140*130)	1 here ne dite
Kompresa operacioni (telina)	1 here ne dite
Perparese operacioni	1 here ne dite
Kapuçe te salles	1 here ne dite
Kostumet e ekipit te salles	1 here ne dite

MATERIAL TE BUTA PERSONEL MJEKSOR	Frekuence
Perparese mjeku, reanim, infermiere	51-here ne vit
Kostume mjeku, infermieri	51-here ne vit
Peshqire	102- here ne vit
Pandofla personeli	2-here ne vit

Tërheqja dhe dorëzimi i inventarit të materialit të butë në pavione, do të bëhet me grafik të hartuar nga Sektori i Sherbimeve te Brendshme së Spitalit të SUT-së. Grafiku është i detyruar të zbatohet nga të dyja palët, dhe në rastet e ndryshimit të tij, miratimi duhet të bëhet me nënshkrim po nga të dyja palët.

Përdorimi i inventarit të materialit të butë brënda pavionit, bëhet dhe mbetet nën përgjegjësinë e personelit të sipërmarrësit të kontrolluar nga autoriteti kontraktor, sipas procedurave të mëposhtme:

Etapat e këtij procesi çdo ditë:

- Çdo ditë K/infermierja e pavionit ose personi i autorizuar prej saj, përpilon, siglon dhe dorëzon, kërkesën (Fletë Forcën e Pavionit) për ditën e nesërme për material të butë, duke cilësuar numrin shtrimeve të reja, të cilën e dorëzon brënda orës 12:00 tek Sektori i Sherbimeve te Brendshme të SUT-së.
- Sektori i Sherbimeve te Brendshme të SUT-së, në bazë të kërkesave ditore (fletëve të forcave të pavionit) dhe grafikut të pavioneve, harton evidencën ditore përmbledhëse ne total per gjithë Spitalin, dhe ia dorëzon sipërmarrësit brënda orës 13:00 për ditën pasardhëse.
- Peshimi dhe numërimi i materialit të butë të larë, të thatë, të hekurosur, si dhe të paketuara do të bëhet çdo ditë në ambjentet që do caktohen nga Autoriteti Kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës, çdo ditë në orën 08:00 nën prezencën e përfaqësuesit të autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesit të sipërmarrësit, duke mbajtur proces-verbalin përkatës të firmosur nga palët. Ky dokument do ketë vlerë financiare, pasi likuidimi i operatorit ekonomikë do të bëhet mbi bazën e proces verbaleve të nënshkruara nga palët për çdo ditë.
- Vetëm pasi të jetë peshuar dhe numëruar, materiali i butë është gati për tu shpërndarë nga Sipërmarrësi në shërbimet përkatëse, sipas kërkesave të shërbimit të bërë një ditë më parë. Materiali i butë do të dalë me copë dhe do të hyjë i larë me kilograme.
- **Shpërndarja e materialit të butë** në pavione, do të bëhet nga sipërmarrësi çdo ditë pas orës 7:00 deri në orën 15.00, sipas grafikut të përpiluar nga Sektori i Sherbimeve te Brendshme dhe miratuar nga palët.
- Sipërmarrësi ia dorëzon materialin e butë Kryeinfermierit të pavionit në bazë të grafikut të hartuar nga Sektori i Sherbimeve te Brendshme. Për çdo rast, dorëzimi i materialit të butë do të bëhet vetëm pasi ky material i butë të jetë peshuar, numëruar dhe në momentin e dorëzimit do të mbahet procesverbali i dorëzimit (në kilograme) i firmosur nga të dyja palët, nga Gupi i pritjes së mallit të SUT si dhe nga Kryeinfermieri i Pavionit/Shërbimit përkatës, në 3(tre) ekzemplarë. Kryeinfermieri i pavionit dhe Grupi i pritjes së mallit bën kontrollimin për lartësinë, hekurosjen, cilësinë e materialit të butë dhe në rast kostatimi të

materialit të butë difektoz ose të papastër, e kthen mbrapsht duke e pasqyruar në procesverbal. Ky procesverbal duhet të ketë të saktësuar numrin e materialit të butë të marrë në dorëzim nga Kryeinfermieri i pavionit.

- K/infermierja e pavionit ose personi i autorizuar prej saj se bashku me Grupin që pret mallin, do të evidentojnë dhe konfirmojnë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me shërbimin që kryhet, cilësinë dhe sasinë e kërkuar, si dhe për çdo parregullsi do të konfirmojnë dhe informojnë me shkrim në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme të SUT.
- Tërheqja e materialeve të buta të ndotura nga pavioni, do të bëhet nga sipërmarrësi deri në orën 15.00, duke iu referuar Rregullores në parandalimin e infeksioneve spitalore.
- Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës, prej ditës së hënës deri ditën e dielë, (operatori ekonomik duhet të sigurojë edhe materialin e butë për mbulimin e nevojave në pavion, dhe shtrimin e shtratit të pacientit, gjatë fundjavës) gjatë 8 orëve, ndërsa për Shërbimet e Urgjencës e Reanimacionit do të jete 24-orësh, edhe sipas kërkesës së Kryeinfermierit të pavionit në rast të ndryshimit të materialit të butë bëhet i domosdoshëm për pacientë të veçantë.
- Në të gjitha rastet, kur shërbimet kanë nevojë për material të butë shtesë, vetëm pas miratimit të kërkesës së shefit të shërbimit nga Sektori i Shërbimeve të Brendshme, Sipërmarrësi do të procedojë me dorëzimin e materialit të butë shtesë, të kërkuar nga shërbimi.
- Në raste të konstatimit të mungesave dhe/ose dëmtimit të materialit të butë për periudhën e lënë nën administrim e personelit të Spitalit të SUT-së, do të mbahet një procesverbal, të firmosur nga të dyja palët, një kopje e të cilit do të dorëzohet në sektorin e Shërbimeve të Brendshme dhe sipërmarrësi do të bëjë menjëherë zëvendësimet përkatëse.
- Riparimi i materialit të butë të dëmtuar, bëhet nga sipërmarrësi duke ruajtur përmasat, dimensionet, përbërjen fillestare (të gjitha specifikimet teknike të materialit të butë).
- Sipërmarrësi detyrohet të zëvendësojë materialin e butë të vjetëruar në përdorim me material të butë të ri sipas jetëgjatësisë së çdo materiali të butë dhe sipas nevojës.
- Në të gjitha rastet kur sipërmarrësi dhe/ose autoriteti kontraktor konstatojnë material të butë të dëmtuar, të dy palët mbajnë një proces verbal dhe më pas procedohet me nxjerrjen nga përdorimi të këtij materiali të butë.
- Për raste të gjendjes së jashtëzakonshme, epidemive apo pandemive, lavanderia do të funksionojë sipas kushteve që do të vendos Drejtoria e Spitalit të SUT-së.
- Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë në prani të përfaqësuesit të sipërmarrësit, dhe të përpilojë akt kontrole nga sektorë të ndryshëm të saj, në bazë të programeve të punës, për të evidentuar çdo parregullsi në lidhje me kryerjen e shërbimit, sasinë e

materialit të butë të dorëzuar duke rakorduar dhe mbajtur procesverbale përkatëse të shërbimit.

- I gjithë materiali i butë në përdorim, me përfundimin e kontratës, i dorëzohet Spitalit të SUT-së pa kundërpaguesë.
- Të gjitha kostot për ofrimin e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë në Spitalin e Traumes do të sigurohen nga vetë sipërmarrësi.
- Marrëdhëniet financiare midis palëve, do të përcaktohen në momentin e lidhjes së kontratës.
- Spitali i Trames likujdon çdo muaj Sipërmarrësin, bazuar në sasinë e materialit të butë të thatë në kilogramë sipas procesverbaleve të peshimit dhe përmbledhëses mujore të forcës së pavionit, të hartuar nga Sektori i Shërbimeve të Brendshme dhe të miratuar nga të dyja palët. Sektori i Shërbimeve të Brendshme, harton përmbledhësen mujore, duke u bazuar në kopjet e procesverbalit të dorëzimit të materialit të butë në pavione çdo ditë.
- Kur sipërmarrësi nuk bën ndërrimet e materialit të butë të shtratit të pacientit sipas afateve të përcaktuara, me ankesën me shkrim të shërbimit/pavionit, përfaqësuesi i Spitalit të SUT-së përpilon informacionin përkatës duke i bashkëngjitur një proces – verbal, në bazë të të cilit vërtetohet se nuk është kryer shërbimi. Për çdo ditë, shtrati që nuk është ndërruar në afat, sipërmarrësi i mbahet vlefte e llogaritur e materialit të butë të thatë që nuk është ndërruar. Në rastet kur mungesa e shërbimit përsëritet, sipërmarrësi i paguan gjorbë Spitalit të SUT-së, sa dhjetëfishi i vlerës së shërbimit të munguar të llogaritur në shërbim.
- Proces – verbalet për ndalesat dhe gjrobat, i mbahen sipërmarrësit në pagesën mujore të radhës. Ato mund të kundërshtohen nga sipërmarrësi në Drejtorinë e Spitalit të SUT-së brenda muajit (30 ditë) vijues. Jashtë këtij afati, këto procese do të quhen të pranuar nga palët.
- Personeli që punësohet nga sipërmarrësi në shërbimin e lavanderisë, brenda territorit të Spitalit të SUT-së, është i detyruar të zbatojë protokollet e kujdesit të higjienës, të kujdesit infermieror, si dhe rregulloren e SUT-së. Në rastet kur kjo shkelet, punonjësi përkatës largohet nga puna nga sipërmarrësi me kërkesën me shkrim të Drejtorisë së SUT-së, informacionit dhe proces verbalit përkatës.